REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

NENTOR - NOVEMBER

TIRANE, 2004

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Nentor 2004

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL*.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…….13
   d. SEKTORI MONETAR……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

*Të dhënat e sektorit fiskal janë të dhëna paraprake
Fiscal sector data are preliminary data.

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Nentor 2004, arriti ne 104.11 perqind duke shenuar nje rritje prej 0.5 përqind, pas rritjes me 0.2 perqind dhe 0.1 perqind, perkatesisht ne muajt tetor dhe shtator. Norma vjetore e inflacionit ne muajin nentor ishte 2.2 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise, prej 2 - 4 perqind.



- **Kursi mesatar i kembimit** per muajin Nentor 2004, ishte:

  - 98.24 leke per US Dollar
  - 127.28 leke per Euro



Keto reflektojne nje zhvleresim te monedhes sone kombetare, Lekut, kundrejt monedhes europiane, dhe nje renie te metejshme te dollarit amerikan krahasuar me muajin tetor 2004. Ky eshte reflektim i sjelljes se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare.

Normat e interesit te depozitave ne leke, kane vazhduar trendin e tyre renes gjate kesaj periudhe te vitit 2004, si pasoje e likuiditetit te tepert ne ekonomi dhe politikave lehtesuese te ndjekura nga BSH. Normat e interesit pritet të vijojnë të ulen, në përgjigje të uljes së normës bazë të interesit. Renien me te ndjeshme gjate kesaj periudhe e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore, me rreth 1.54 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar. Gjithashtu, renia ka qene e pranishme edhe per depozitat me afat 6 mujor, 3 mujor dhe mujor.



❖ Situata buxhetore

Deri ne fund te muajit Nentor 2004, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth 24.8 miliarde leke, ose rreth 51 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2004.
2. **Te ardhurat** gjithsej arriten ne rreth 165.4 miliarde leke ose rreth 84 perqind e programit vjetor 2004.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 190.1 miliarde leke, ose rreth 77 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2004.



- **Deficiti i pergjithshem** arriti ne 24.8 miliarde leke nga 31.9 miliarde leke te parashikuar per kete periudhe 11-mujore, pra brenda kufijve te parashikuar, duke perballuar ne kete menyre kryerjen e shpenzimeve ne kohen e duhur.

- **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 84 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

  - Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 88 përqind të programimit vjetor;
  - Kontributet për sigurimet shoqërore prej 86 përqind;
  - Të ardhurat jo-tatimore 66 përqind e buxhetit vjetor; dhe
  - Të ardhurat nga pushteti lokal, 80 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 77 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 160.4 miliardë lekë ose rreth 86 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 85 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet shoqerore me rreth 90 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve të larta operative dhe te mirembajtjes me rreth 92 perqind e buxhetit vjetor.

- **Bilanci i pagesave**

Per muajin Qershor te vitit 2004 rezultoi me nje defiçit te pergjithshem prej 0.4 milion $. Kjo ishte rezultat i nje:

  - defiçiti te Llogarise Korente, prej 37 milion $;
  - suficiti te Llogarise se Kapitalit, prej 10.9 milion $;
  - sufiçiti te Llogarise Financiare, prej 21.3 milion $;
  - bilanci pozitiv ne "Gabime dhe Harresa neto" prej 4.4 milion $.



- Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 37 milion $ ishin nje:

  - bilanc tregtar negativ prej 135 milion $;
  - sufiçt prej 18 milion $ ne bilancin e sherbimeve ;
  - suficit prej 10.5 milion $ ne bilancin e te ardhurave ;
  - suficit prej 69.5 milion $ ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.



Në baze kumulative, në fund të 6-mujorit te pare 2004, bilanci i pagesave rezultoi me sufiçit të përgjithshëm, prej 132.3 milionë $.
Komponentët kyç ishin:

  - defiçiti prej 208.3 milionë $, në llogarinë korrente,
  - sufiçiti prej 59.8 milionë $ ne llogarine kapitale,
  - suficiti prej 206.8 milionë $ në llogarinë financiare,
  - bilanc pozitiv i gabimeve dhe harresave neto prej 74.1 milionë $.

- **Oferta totale e parasë,** e matur nga M3 arriti në 487.6 miliardë lekë në fund të muajit shtator, duke shenuar një rritje me rreth 9.9 perqind ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar.



- Rritja u reflektua në rritjen e **depozitave me afat** ne leke me rreth 10 perqind, depozitave ne valute me rreth 12 perqind, depozitave pa afat ne leke me rreth 37 perqind dhe rritje te parase jashte sistemit me rreth 4 perqind, krahasuar me nje vit me pare.



2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit gjate muajit nentor shenoi nje rritje prej 0.5 perqind, pas rritjes me 0.2 perqind dhe 0.1 perqind, perkatesisht ne muajin tetor dhe shtator. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj nje vit me pare ishin 0.4 perqind, 0.2 perqind dhe 0.7 perqind.

Rritja e indeksit te çmimeve te konsumit ne muajin Nentor 2004 prej 0.5 perqind eshte kryesisht rezultat i rritjes se indeksit te grupit "Ushqime dhe pije jo alkolike", me 1.1 perqind. Brenda ketij grupi mund te permendet rritjen e cmimit te nengrupit "zarzavate pershi patatet prej 13.6 perqind. Rritje ka pesuar edhe grupi "Veshje dhe kepuce" me 0.5 perqind. Kjo per aresye te ardhjes se sezonit te ri te dimrit. Grupi "Qera, uje lende djegese dhe energji" shenoi nje rritje prej 0.2 perqind, kjo si rezultat kryesisht i rritjes se cmimit te gazit me 5.5 perqind. Rritje prej 0.2 perqind shenoi edhe grupi "Transport", ku mund te permendim rritjen e cmimit te karburantit prej 1.1 perqind.Disa grupe te tjera kane pesuar ulje, si grupi "Argetim dhe kulture" me -0.2 perqind, dhe "Hotele, kafene dhe restorante" me -0.3 perqind .

Ne muajin nentor, norma vjetore e inflacionit arriti ne 2.2 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Rritjet me te medha vjetore verehen ne grupet "Komunikimi" prej 15.4 perqind, "Sherbimi arsimor" prej 6.7 per qind, "Qera,uje lende djegese dhe energji" me 9.2 perqind.
Ndersa uljet me te medha vjetore verehen ne grupet "Veshje dhe kepuce" me -2.9 perqind dhe "Ushqime pije joalkolike" me -1.6 perqind.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2003 dhe 2004 paraqiten ne tabelen e meposhtme

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nen	Dhj
2004	3.3	4.4	4.0	3.2	2.6	2.9	3.1	2.7	2.0	2.0	2.2	
2003	0.0	1.1	1.4	2.3	2.8	2.6	3.0	3.0	2.7	2.9	3.4	3.3

Kursi mesatar i këmbimit

Gjate muajit **nentor** vihet re nje zhvleresim i metejshem i dollarit amerikan kundrejt monedhes shqiptare ne masen 2.1 perqind, dhe nje forcim i Euros ne masen 1.5 perqind, **kundrejt fillimit te muajit**.

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, ashtu si edhe muajt e meparshem, pesoi perseri nje renie gjate muajit nentor. Ne fund te muajit nentor 2004, ky kurs kembimi arriti vleren 96.97 Lek/USD, krahasuar me mesataren mujore prej 98.24 Lek/USD.

Kursi mesatar i kembimit per Euron arriti ne 127.28 Lek/Euro, ne muajin nentor, duke shenuar nje rritje prej 1.3 perqind, krahasuar me mesataren prej 125.65 te arritiur ne muajin tetor, ndersa ne fund te muajit nentor, nje Euro u kembye me 128.19 Leke.



Gjate muajit Nentor 2004 vihet re nje vleresim mesatar i Lekut kundrejt dollarit dhe nje zhvleresim kundrejt Euros. Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin u ul nga 100.61 Lek/USD ne tetor, ne 98.24 Lek/USD ne muajin nentor, ndersa kursi mesatar i kembimit te lekut me Euron u rrit nga 125.65 Lek/Euro ne 127.28 Lek/Euro ne nentor.

Ne krahasim me muajin nentor te vitit te kaluar rezulton qe monedha shqiptare, eshte vleresuar ndjeshem ndaj dollarit amerikan, ne masen 15.0 perqind dhe rreth 5.7 perqind kundrejt monedhes europiane.

Ndikimin me te madh ne ecurine e kursit te kembimit te dollarit amerikan e ka patur faktori i jashtem. Ne tregjet nderkombetare, kembimi i euros me dollarin amerikan arriti nivelet me te larta historike, 1.322 dollare/euro gje qe ka reflektuar edhe ne tregun tone valutor.

Forcimi i lekut ndaj valutave, gjate muajve te fundit, ka rezultuar dhe nga faktore te brendeshem, sic mund te permendim rritjen e prodhimit te brendeshem bujqesor qe ka

ndikuar ne uljen e importeve per keto produkte e per rrjedhoje edhe ne uljen e kerkeses per valute. Niveli i ulet i inflacionit ka ruajtur interesin real per lekun ne nivel te favorshem per ta bere kete monedhe me te preferuar kundrejt te tjerave. Per me teper diferenca positive e kenaqshme midis norms se interesave ne leke dhe atyre ne valute ka ruajtur te larte kerkesen per monedhen vendase.

Interesi i huave 12 mujore ne muajin shtator u ul me rreth 3.55 perqind, duke arritur ne 15.02 perqind nga 18.57 perqind qe ishte nje muaj me pare, ndersa interesi i huase 6-mujore u ul nga 11.27 perqind ne muajin gusht ne 11.20 perqind ne muajin shtator.



Gjate muajit shtator, normat e interesit te Bonove të Thesarit rezultojne me renie te lehte. Keshtu ato me maturim 12 mujor u ulen ne 8.14 perqind nga 8.95 përqind qe ishte gjate muajit gusht, ndersa interesat e bonove te thesarit 6 mujore u ulen nga 8.04 perqind ne 7.28 perqind ndersa ato me maturim tremujor arriten ne 6.21 perqind ne muajin shtator 2004.

b. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Nentor, jane mbledhur rreth 165.4 miliarde leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 190.2 miliarde leke, qe perfshijne 160.4 miliarde leke ne shpenzime korente dhe 29.7 miliarde leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e 24.8 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 84% te te ardhurave buxhetore per vitin 2004, ndersa shpenzimet perbejne 77% te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 86% e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 54% e ketij planifikimi.
Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 111 miliarde leke (ose rreth 88% e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 9.1 miliarde leke (80% e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 29.1 miliarde leke (86% e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 13.8 miliarde leke (66% e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 160.4 miliarde leke, 42.4 miliarde leke (26.4 %) eshte shpenzuar per personelin, 26.5 miliarde leke (16.5%) per interesat, 20.6 miliarde leke (12.8%) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 4.1 miliarde leke (2.6%) per subvencione, 44.8 miliarde leke (27.9%) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe 22 miliarde leke (13.7%) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 83% (shpenzime personeli), 85% (shpenzime per interesat), 92% (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 99% (subvencione), 90% (sigurimet shoqerore), 75% dhe 87% (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 29.7 miliarde leke nga te cilat 67% financim i brendshem, dhe 33% financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem llogariten per kete periudhe ne rreth 64% te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 42%.

Deficiti prej 24.8 miliarde leke eshte i barabarte me 51% te deficitit buxhetor per 2004.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Nentor 2004 ne rreth 165 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 149.2 miliardë, grantet 2.4 miliarde dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 13.8 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 111 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 9.1 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 29.1 miliarde leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Nentorit:

- TVSH përbënte 53.3 miliardë lekë
- Tatimi mbi fitimin 14.7 miliardë lekë
- Taksa doganore 12.2 miliardë lekë
- Taksat nacionale 9.6 miliardë lekë
- Akcizat 14 miliardë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 4.3 miliardë lekë;

Financimi i Defiçitit

Defiçiti prej 24.8 miliardë lekë, ne fund te Nentorit 2004, ishte 79 përqind me financim të brendshëm dhe 21 përqind me financim të huaj. Te ardhurat nga privatizimi dhe emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për muajin Qershor ishin:

Nje defiçit i pergjithshem prej 0.4 milion $. Kjo ishte rezultat i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 37 milion $;
- suficit te Llogarise Kapitale, prej 10.9 milion $;
- sufiçit te Llogarise Financiare, prej 21.3 milion $;
- bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 4.4 milion $.

Asetet rezervë u rriten me 2 $ milionë;

Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 37 milion $ ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 135 milion $;
- sufiçit prej 18 milion $ ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 10.5 milion $ ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 69.5 milion $ ne levizjet e transfertave dhe dergesave.

Zërat kryesorë në flukset pozitive në llogarinë kapitale dhe llogarine financiare përfshijnë:

- flukset pozitive të investimeve direkte prej $20 milionë,
- flukset të investimeve në investimet fizike prej $0 milionë
- flukset pozitive të kapitaleve të tjera prej $1.3 milionë.

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate nentemujorit te 2004, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, me rreth 385.5 milione dollare krahasuar me fundin e vitit 2003.



Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 168.9 milione usd, nderkohe qe mjetet valutore neto te B.Sh. jane rritur me 216.7 milione dollare. Pjesa me e madhe e kesaj rritjeje ka ardhur kryesisht nga mbicmimi me 1.9 perqind i euros ndaj dollarit amerikan ne tregun nderkombetar (gje qe ka rritur vleren e investimeve ne euro te shprehura ne dollare amerikane) si edhe nga prania e Bankes se Shqiperise ne tregun valutor ne kahun e blerjes se valutes.

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit shtator 2004 qendroi ne te njejtin nivel me muajin paraardhes, ne rreth 61 miliard leke. Rritja e teprices se kredise mbeti ne nivelin 10.2 miliarde leke.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas afateve vërehet rritja e peshës së kredive afatmesme dhe afatgjata. Në fund të muajit shtator, teprica e kredisë afatmesme dhe afatgjatë përbënte 66 përqind të tepricës së kredisë gjithsej. Teprica e kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke perbere 83 perqind te totalit te treprices se kredise.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), kapi shifren rreth 487.6 miliardë lekë në fund të muajit shtator duke shenuar nje rritje prej 0.5 perqind krahasuar me nje muaj me pare, ndersa rritja vjetore e ketij treguesi ishte 9.9 perqind. Kontributin kryesor në këtë rritje e kane dhene depozitat ne leke, te cilat kane pesuar nje rritje mujore me 4.3 miliarde leke nderkohe qe niveli i parase jashte bankave eshte ulur me 2.6 miliarde leke. Depozitat ne valute paraqesin nje rritje prej 0.8 miliarde leke.



Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, gjate muajit shtator kapi shifren 25.9 perqind, duke qene 0.7 pike perqindje me ulet krahasuar krahasuar me nje muaj me pare. Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin shtator arriti shifren 34.9 perqind, duke shenuar nje renie prej 2.4 perqind krahasuar me muajin e kaluar.

Depozitat ne leke si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje rritje vjetore prej 12.1 perqind, ose rreth 1.8 perqind krahasuar me nje muaj me pare.

Depozitat në valutë, kanë shfaqur një rritje vjetore te njejte me depozitat ne leke me rreth 12.1 perqind. Ecuria e depozitave ne valute eshte ndikuar ne nje mase te madhe nga zhvillimet ne kursin e kembimit, me prirjen historike të depozitave në këtë muaj. Rritja e ofertës së valutës së huaj gjatë sezonit turistik, ka ndikuar drejpersedrejti rritjen e depozitave në valutë.

Depozitat sipas Burimeve

Kjo tabelë tregon përbërjen e depozitave te cilat kontribuojnë në përkufizimet e ndryshme të ofertës së parasë (Tabela 15) sipas llojit të depozituesve.

Një shqyrtim i tabelës tregon se gjate nentemujorit 2004:

- Sektori privat ishte burim i rëndësishëm i depozitave pa afat ne leke (rreth 49.4 perqind) ndjekur nga ndermarjet jofinanciare publike (rreth 22.1 perqind) dhe individet me 20.1 perqind.

- Sektori privat si edhe individidet ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave pa afat në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 43.1 perqind dhe 44.0 perqind, me nje diference midis tyre per muajin Nentor vetem prej 0.9 pike perqindjeje.

- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.4 përqind e totalit) dhe depozitave me afat në monedhe të huaj (me 91.8 përqind e totalit te depozitave;

- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 83.2 përqind) të depozitave totale prej 361 miliardë lekësh ne muajin nentor 2004. Ata ndiqen nga sektori privat (11.1 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (4.5 përqind) dhe autoritetet lokale (0.8 përqind). Institucionet financiare kontribuan me 0.4 për qind ne totalin e depozitave.

- Gjatë muajit Nentor 2004, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 5.1 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave me afat në lekë (1.6 miliardë lekë), depozitave me afat ne monedhe te huaj (1.9 miliarde leke), depozitave pa afat ne leke (2.7 miliarde leke) dhe renies se depozitave pa afat ne valute (1.1 miliarde leke).

- Depozitat me afat ne valute te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 1.5 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne lek te familjareve gjate muajit nentor u rriten me rreth 2.7 miliarde leke

Ne menyre grafike, kontributi i sektoreve ndaj totalit te depozitave paraqitet: